

UDHËZIME
PËR PËRGATITJEN E SHITESËS SË DIPLOMËS
(DIPLOMA SUPPLEMENT)
Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 84, 06.07.2009

Shembujt që theksohen në Udhëzim shërbejnë si ilustrime të cilat mund të përshtaten për nevojat e veta. Në rastin kur në një tërësi të caktuar nga shtesa e diplomës paraqitet nevoja për informata plotësuese, ato mund të përfshihen nëse janë në përputhje me tërësinë dhe nëse janë të domosdoshme për kuptimin e kualifikimit arsimor. Kjo veçanërisht ka të bëjë me tërësitë përmbajtja e së cilave nuk është e definuar në mënyrë precize (3,4,5 dhe 6).

1. Të dhëna për bartësin e diplomës

- 1.1. **Emri:** Shënoni emrin e studentit
- 1.2. **Mbiemri:** Shënoni mbiemrin e studentit
- 1.3. **Ditëlindja, vendbanimi dhe shteti i lindjes:** Shënoni datën (dita, muaji dhe viti), vendi dhe shteti i lindjes.
- 1.4. **Numri personal:** kjo njësi duhet të mundësojë njohje pa mëdyshje të studentit të cilit i jepet dokument dhe duhet të përmbajë EMB (numër personal) të studentit (numri i vetëm amzë) dhe numrin e dosjes së studentit.

2. Të dhëna për kualifikimin e fituar

- 2.1. **Data e dhënies:** shënoni datën kur është dhënë diploma për kualifikimin e fituar.
- 2.2. **Emërtimi i kualifikimit (në gjuhën maqedonase, përkatësisht në gjuhën në të cilën është dhënë diploma):** shënoni emërtimin e plotë të kualifikimit ashtu siç është shkruar në diplomë, përkatësisht në dokumentin e dhënë. Emërtimi i kualifikimit duhet të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për arsimin e lartë, përkatësisht të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, si dhe emërtimi i theksuar në programin studimor. Shënoni nëse bëhet fjalë për diplomë të përbashkët, apo kualifikimin e japin më shumë institucione të arsimit të lartë. Shënoni nëse diploma bart edhe titull të parashikuar me akt të veçantë dhe shënoni për cilin titull bëhet fjalë. Shënoni nëse ky titull është i mbrojtur me ligj. Shënoni nëse me përfundimin e studimeve personi mund të punojë si kuadër profesional në ndonjë fushë (p.sh. mësimdhënës ose profesor ose). Gjatë shënimit të emërtimit, shfrytëzoni emërtime të cilët përshtaten sipas gjinisë së caktuar. Në këtë njësi mund ta shënoni edhe vetëm nivelin e kualifikimit, pa e theksuar fushën studimore.

2.3. Emri i programit studimor: Shënoni sferën kryesore të studimeve, fushën dhe lëmin kryesor të studimeve. Nëse ekzistojnë nënfusha dhe specializime, shënoni qartë se cilat janë. Shënoni në qoftë se bëhet fjalë për studimet dy lëndore. Në këtë njësi duhet të shënohet fusha shkencore në kuadër të së cilës zhvillohet programi studimor. Në këtë njësi nuk ka nevojë të shënohet niveli i kualifikimit (p.sh. studimet deridiplomike, përkatësisht cikli i parë). Në shtesën e diplomës në gjuhë të huaj në këtë njësi përdorne edhe atë gjuhë.

Shembull:

- **Shkencat teknike - elektroteknikë - rryma e dobët**
- **Shkencat humane - Filozofi - gjuhë dhe letërsi angleze**
- **Shkencat shoqërore - Sociologji – sociologjia ekonomike**
- **Shkencat bioteknike – Pylltari – përpunimi i drurit**

2.4. Emri (në gjuhën zyrtare) dhe statusi i institucionit të arsimit të lartë/institucionit shkencor, i cili e jep diplomën: shënoni

2.4. Emri (në gjuhën zyrtare) dhe statusi i institucionit për arsim të lartë/institucionit shkencor i cili e jep diplomën: shënoni emrin e institucionit për arsim të lartë i cili e jep kualifikimin. Shënoni këto të dhëna lidhur me statusin juridik e institucionit për arsim të lartë: llojin e institucionit për arsim të lartë, a është publik apo privat, aktvendimin për akreditim dhe datën e aktvendimit për plotësimin e kushteve për fillimin me punë. Nëse institucioni për arsim të lartë nëpër procedurë të veçantë për akreditim (për shembull: institucion i huaj), ose me procedurë të veçantë dhe është vlerësuar kualiteti, të shënohet në këtë tërësi. Nëse diploma shtesë jepet për studime të përbashkëta ose studime të dyfishta (jonit or double degree) shënoni statusin juridik të të gjitha institucioneve të cilat i kanë zhvilluar studimet duke i shënuar pjesët e programeve studimore që janë zhvilluar.

Shembull:

Universiteti Shtetëror „Goce Dellçev” në Shtip, Fakulteti Juridik në Koçanë, Aktvendimi për akreditim i Këshillit për akreditim nr. _____, Aktvednimi për fillimin e punës nga Ministria për Arsim dhe Shkencë numri dhe data _____.

2.5. Emri dhe statusi i institucionit (nëse është i ndryshëm nga pika 2.4) i cili i administron studimet: Kjo tërësi ka të bëjë me institucionin i cili është përgjegjës për realizimin e studimeve. Në cilat kushte ky institucion mund të jetë i ndryshëm nga institucionet sipas pikës 2.4. dhe me këtë rast, këtu shënoni të dhënat përkatëse e parapara sipas pikës 2.4.

2.6. Gjuha e mbajtjes së mësimi: Shënoni gjuhën ose gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi dhe mbahen provimet. Nëse ekziston pjesë e konsiderueshme e obligimeve në studime për të cilat studentit i nevojitet njohje e gjuhës së huaj për përvetësimin e njohurive të cilat janë lëndë e studimeve (për shembull: letërsi në gjuhë të huaj) shënojeni këtë në këtë tërësi: Mund të shënohet edhe numri i ECTS kredive të fituara me përvetësimin e këtyre detyrimeve.

3. Të dhëna për nivelin (ciklin) e kualifikimit

Në këtë njësi definoohen nivelet e kualifikimit: lloji programit studimor (studimet a janë akademike apo profesionale), cikli i programit studimor, kohëzgjatja oficiale e programit studimor, kushtet e regjistrimit të studimeve.

3.1. Lloji i kualifikimit (studime akademike/profesionale): shënoni a bëhet fjalë për studime universitare (akademike) apo për studime profesionale.

3.2. Niveli (cikli) i kualifikimit: shënoni për cilin nivel (cikël) të studimeve bëhet fjalë – cikli i parë (studime deridipomike), cikli i dytë (studime të magjistraturës/specializimit), cikli i tretë (studime të doktoratës).

3.3. Kohëzgjatja e programit studimor (shprehur në vite dhe ECTS kredi): Shënoni kohëzgjatjen e paraparë të studimeve sipas semestrave dhe viteve të studimit siç është theksuar në aktvendimin për akreditim. Shënoni edhe ngarkesën e punës së

studentit të shprehur në minimum të ECTS kredive të nevojshme për kryerjen e studimeve. Shënoni nëse kjo është e paraparë për ciklin e dhënë të studimeve, se a është dhënë mundësi për vazhdimin e statusit akademik apo vazhdimin e kohëzgjatjes së studimeve. Është e nevojshme të shënohen edhe pjesë të tjera përbërëse të rëndësishme të studimeve, siç janë puna në terren dhe puna më e gjatë praktike. Është e preferuar që të jepen sqarime për kohëzgjatjen e studimeve përmes shënimit të orëve të punës javore të shumëzuar me numrin e javëve.

3.4. Kushtet për regjistrim në programin studimor: shënoni nivelin e arsimimit si parakusht të nevojshëm për pjesëmarrje në regjistrimin e studimeve të theksuara. Në emërtimin e nivelit të arsimimit shënoni kohëzgjatjen minimale të këtyre niveleve sipas semestrave ose viteve, ose sipas numrit të ECTS kredive të fituara (me të cilën përshkruhet ngarkesa e studentit). Nëse institucioni për arsim të lartë ka përcaktuar emërtim të saktë të kualifikimit i cili është paraparë për regjistrim në këto studime, shënojeni këtë emërtim. Nëse institucioni për arsim të lartë ka përcaktuar kushte plotësuese për regjistrimin e studimeve, shënojeni këtë. Nëse ekzistojnë një numër i madh i përjashtimeve, ose nëse kushtet përcaktohen veçmas, drejtohuni në vendin ku mund të merren informacione të sakta për kushtet e regjistrimit. Nëse si kusht për regjistrimin e studimeve pranohen disa elemente të mësimit formal, shënojeni këtë në këtë njësi.

4. Të dhëna për përmbajtjet dhe rezultatet e arritura

4.1. Mënyra e studimeve (e rregullt, me korrespondencë): Kjo njësi ka të bëjë me mënyrën e studimit të programit studimor. Këtu përshkruhet në cilën mënyrë ka studiuar studentit konkret për të cilin jepet shtesa e diplomës (studime të rregullta ose studime me korrespondencë) dhe si i ka kryer studimet e theksuara.

4.2. Kërkesat dhe rezultatet e programit studimor: në këtë njësi është e nevojshme të shënohen të gjitha informacionet të cilat lexuesit të shtesës së diplomës do t'i ndihmojnë ta kuptojë cilat njohuri, shkathtësi dhe kompetenca i fiton studentit i cili i kryen studimet e theksuara. Pastaj, shënoni kushtet minimale për fitimin e kualifikimit të theksuar. Shënojeni edhe nëse përveç provimeve ekzistojnë edhe elemente të

obligueshme të studimeve të cilat studenti duhet t'i përmbush me sukses. Shënoni edhe kushtet për përfundimin e studimeve, siç është gjatësia minimale e punimit përfundimtar, a është e nevojshme që punimi përfundimtar të mbrohet, a ka punë praktike dhe sa është kohëzgjatja e saj, dhe a ka provim përfundimtar. Nëse në shtesën e diplomës nuk i shënoni të gjitha të dhënat e detajuara, shënojeni ueb faqen në të cilën ato mund të gjenden.

4.3. Të dhëna për programin studimor (modulet ose njësitë e studimit), notat dhe kreditë ECTS: Në këtë njësi përshkruhen detyrimet të cilat e ka pasur studenti gjatë kohës së studimeve, cilat provime i ka dhënë dhe çfarë suksesi ka arritur. Shënoni të dhëna për të gjitha provimet e dhëna sipas lëndëve, ushtrimet, seminarët dhe detyrimeve të tjera të studimeve në pajtim me programin studimor. Shënoni se studenti a ka shkruara dhe mbrojtur punim përfundimtar dhe cilën e ka pasur temë. Shënoni nëse ekzistojnë të dhëna si janë kreditë ECTS ose ngarkesa e punës të ndara sipas pjesëve të lëndës (p.sh. ligjërata, ushtrime, punime seminari, punë individuale). Nëse shtesa e diplomës ka të bëjë me studime të përbashkëta, në këtë pjesë të shtesës së diplomës shënojeni se cili obligim është dhënë dhe është dhënë provimi (module dhe njësi të studimit) dhe në cilin institucion për arsim të lartë.

Nëse institucioni për arsim të lartë jep vërtetim të veçantë përfundimtar të notave (certifikatë për provimet e dhëna) atëherë mjafton në këtë pjesë të shtesës së diplomës të referohet në këtë vërtetim të notave. Në këtë rast studenti nuk do të ketë mundësi ta shfrytëzojë këtë shtesë të diplomës nëse nuk e bashkëngjit edhe vërtetimin përfundimtar të notave.

Në këtë njësi duhet të shënohen këto të dhëna:

- Numri rendor i lëndës;
- Kodi (shifra) e lëndës;
- Emri i lëndës;
- Numri i paraparë i orëve të mësimi për secilën lëndë;
- Nota përfundimtare për cedilën lëndë;
- Kreditë ECTS të fituara për secilën lëndë;
- Semestri ose viti i studimeve në të cilin lënda është dëgjuar;

- Lëndët zgjedhore (me cekjen e semestrit ose vitit në të cilin ndëgjojen);
- Emri dhe mbiemri i mentorit në punimin përfundimtar;
- A ka patur obligim që ta mbrojë punimin përfundimtar dhe nëse po, kur është mbrojtur;
- Data e mbarimit të studimeve;
- Data e fillimit të studimeve;
- Numri i dokumentit për përfundimin e studimeve (diploma ose dëftesa);
- (Për studimet e përbashkëta) cili obligim është kryer dhe në cilin institucion të lartë arsimor, si dhe në cilin institucion të lartë arsimor është dhënë provimi.

4.4. Sistemi i vlerësimit dhe, nëse është e mundur, rezultatet e arritura për secilën pjesë përbërëse që merren parasysh gjatë vlerësimit: në këtë njësi përshkruajeni në mënyrë më të detajuar sistemin sipas të cilit është vlerësuar suksesi i studentit, respektivisht tregojeni skemën e notave pre 5-10, ku 5 është notë negative. Përmende pjesëmarrjen në aktivitetet e realizuara gjatë marrjes së notës, si që janë rregullsia dhe aktiviteti i studentit, seminarët dhe obligimet e tjera të kryera me shkrim, kolokiumet e dhëna etj. Nëse disa pjesë të programit studimor janë vlerësuar me përshkrim, në atë rast në këtë njësi për këto obligime shkruani “i përfunduar” . Në këtë njësi i cekni kriteret për marrjen e notave (p.sh. për notën 6 duhet të fitohen 51-60 pikë; për notën 7 duhen prej 61-70 pikë etj.)
 Theksojeni se për t’i përfunduar studimet patjetër duhet që studenti të merr nota kaluese në të gjitha lëndët e programit studimor.

4.5. Nota mesatare gjatë studimeve: Përmendeni notën mesatare të studimeve. Nëse ekziston emërtim i veçantë për suksesin e arritur, përmendeni edhe atë. Në shtojcën e diplomës, në gjuhë të huaj paralel me termet e notave në gjuhë të huaj, theksojeni edhe termet në gjuhën maqedonase.

5. Të dhëna për shfrytëzimin e kualifikimit

5.1 Qasje në studime të mëtutjeshme: numëroni nivelet më të larta të studimeve për të cilat kualifikimi ofron qasje dhe veçanërisht theksoni mundësitë për vazhdimin e studimeve në programet e larta profesionale dhe në programet studimore akademike. Përmendni nëse ekzistojnë kushte plotësuese për qasje në nivel më të lartë të studimeve (p.sh. vendimi i institucionit të lartë arsimor për regjistrim të studimeve akademike nëse studenti i ka kryer studimet profesionale). Theksoni nëse ekziston nivel minimal i suksesit të studimeve të cilin studenti ka mundur ta arrijë që të mund të regjistrohet në nivel më të lartë të studimeve. Theksoni nëse kualifikimi është kryer ose është vetëm parakusht për vazhdimin e studimeve në nivel më të lartë.

5.2 Statusi profesional (nëse aplikohet): në këtë tërësi definohet statusi profesional të cilin studenti e fiton me përfundimin e programit studimor të caktuar. Përmendni edhe kualifikimin i cili u mundëson studentëve kryerjen e praktikës së vet ose a fitojnë studentët ndonjë titull ose status profesional me përfundimin e programit studimor. Në rast se kualifikimi studentëve ua mundëson kryerjen e praktikës së tyre, por ekzistojnë disa kushte (si p.sh. provimi profesional), theksoni se cilat janë rregullat në fuqi. Theksoni nëse kualifikimi mundëson qasje në profesionin e rregulluar i cili përndryshe nuk mund të ushtrohet pa kualifikim, dhe a ekzistojnë çfarëdo kushte të tjera plotësuese të cilat studenti duhet t'i plotësojë për fillimin e kryerjes së praktikës (p.sh. dhënie mësim në shkollë të mesme).

Nëse kualifikimi u mundëson studentëve kryerje të praktikës ose qasje në profesionin e rregulluar, theksoni se si kjo është rregulluar (p.sh. me kushtet e odave të degëve përkatëse, ligjit ose me diçka tjetër).

6. Informata plotësuese

6.1. Informacione plotësuese për studentin: theksoni të gjitha informacionet plotësuese të cilat nuk janë përfshirë në njësitë e mëhershme, e të cilat janë të lidhura me vlerësimin e qëllimeve, niveleve dhe shfrytëzimin e kualifikimeve. P.sh., a ka studiuar bartësi i kualifikimit jashtë vendit ose a ka qenë në praktikë profesionale

jashtë vendit. Mund të përmenden edhe shpërblimet eventuale, bursat ose mirënjohjet jashtë aktiviteteve mësimore të studentit. Nëse këtu shtohen informatat të cilat nuk janë pjesë përbërëse e programit studimor (p.sh. puna në organizatat studentore, përfaqësimi studentor, çmimet ose suksesi në studime, të cilat nuk i ka dhënë institucioni i arsimit të lartë e cila e jep kualifikimin), institucioni i arsimit të lartë duhet t'ua mundësojë të gjithë studentëve me kushte të njëjta t'i dorëzojnë informacionet për këtë tërësi. Duke patur parasysh që shtesa e diplomës është dokument publik i studentit, institucioni i arsimit të lartë duhet t'i definojë kushtet me të cilat mund të shfrytëzohen të dhënat për aktivitetet studentore gjatë studimeve të cilat nuk i ka përfshirë institucioni i arsimit të lartë. Në këtë tërësi përmendni nëse studentit ka kryer studime të përbashkëta ose nëse studimet janë kryer në më shumë shtete.

6.2. Informata plotësuese për institucionin e arsimit të lartë: (emri i institucionit, adresa, telefoni, e-maili, ueb faqja etj.): theksoni ku është e mundur të kërkohen informata plotësuese të dobishme për kualifikimin, p.sh. ueb faqja e institucionit të lartë arsimor, klasa ENIC/NARIC etj. Preferohet që të jepen informata për kontakt për pyetje eventuale.

7. Verifikimi i shtojcës së diplomës

7.1. Vendi dhe data: vendi dhe data e lëshimit të shtojcës së diplomës për programin studimor. Nuk duhet të jetë data e njëjtë e lëshimit të dokumentit të programit studimor (diplomë, dëftesë etj.).

7.2. Emri dhe nënshkrimi: emri dhe nënshkrimi i personit i cili e verifikon shtojcën e diplomës.

7.3. Funkcioni i nënshkruesit: funksioni i nënshkruesit në fund të shtojcës së diplomës.

7.4. Vula: vula zyrtare e institucionit i cili e jep shtojcën e diplomës.

8. Informacione për sistemin e institucionit të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë

8.1. Llojet e institucioneve të arsimit të lartë: të bëhet përshkrim i shkurtër i misionit dhe veprimtarisë së universitetit dhe shkollës së lartë profesionale.

8.2. Lloji i studimeve: të shpjegohen qëllimet e studimeve akademike dhe profesionale, si dhe natyra e njohurive dhe aftësive që studentët i fitojnë pas kryerjes së tyre.

8.3. Akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë: të shpjegohet sistemi i akreditimit dhe të theksohet roli i Këshillit për akreditim dhe i Agjencisë për evaluim për sigurimin e kualitetit në arsimin e lartë.

8.4. Struktura e programeve studimore universitare (akademike) në institucionet e arsimit të lartë: të jepet një përshkrim i shkurtër i cikleve të arsimit të lartë universitar, kohëzgjatja e tyre, kreditë ECTS që fitohen, thirrja profesionale/shkencore që fitohet pas kryerjes së tyre, edhe atë: cikli i parë i studimeve universitare, cikli i dytë i studimeve universitare, studimet e integruara, cikli i tretë i studimeve universitare – studimet e doktoratës, studimet specialistike të ciklit të tretë.

8.5. Struktura e studimeve profesionale: të bëhet përshkrim i shkurtër i studimeve profesionale: kohëzgjatja e tyre, kreditë ECTS që fitohen, thirrja profesionale që fitohet si dhe përshkrim i shkurtër i studimeve profesionale specialistike: kohëzgjatja e tyre, kreditë ECTS dhe thirrja që fitohet.

8.6. Kushtet për regjistrimin e studimeve: të përmenden kushtet për regjistrim të secilit lloj dhe secilit cikël të studimeve të arsimit të lartë.

8.7. Sistemi i vlerësimit: të bëhet përshkrimi i sistemit të vlerësimit i cili aplikohet në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë.